V E N D I M
Nr.498, datë 10.10.1994

PËR FUQIZIMIN E KONTROLLIT TË MJETEVE MATËSE

Në mbështetje të ligjit nr.7723, datë 21.6.1993 "Për një shtesë në ligjin nr.7512, datë 10.8.1991 "Për sanksionimin dhe mbrojtjen e pronës private, të nismës së lirë, të veprimtarive private të pavarura dhe të privatizimit", si dhe të ligjit nr.7625, datë 20.10.1992 "Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)" Këshilli i Ministrave,

V E N D O S I:

1. Regjistrimi në gjykatë për personat fizikë dhe juridikë, vendas e të huaj, që merren me veprimtari në sektorët e tregtisë, të shpërndarjes, të shërbimit, të shëndetësisë, të higjienës, të sigurimit teknik dhe të mbrojtjes së mjedisit nga ndotjet, të bëhet pasi të paraqitet leja përkatëse e dhënë edhe nga degët e kontrollit dhe kalibrimit të mjeteve matëse në rreth.

2. Leja të jepet pasi të interesuarit të regjistrohen në dokumentet përktëse të mjeteve matëse në rreth.

3. Ngarkohet Drejtoria Kombëtare e Metrologjisë dhe e Kalibrimit të hartojë dokumentacionin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE
Aleksandër Meksi